

DANIELE MENCARELLI
GJITHÇKA KËRKON SHPËTIM
ROMAN

BOTIMET TOENA

DANIELE MENCARELLI

GJITHÇKA
KËRKON SHPËTIM

roman

Përktheu nga origjinali italisht Erion Gjatolli

BOTIMET TOENA

Tiranë

Autori: Daniele Mencarelli
Titulli në origjinal: Tutto chiede salvezza
Botoi në italisht: Mondadori

Questo libro é stato pubblicato con il contributo del Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale italiana. Ky libër u publikua me kontributin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Kooperacionit italian.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Sonila Kryeziu

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Kopertina: Erdita Oshafi

© Imazhi në kopertinë: Enea Toçi

ISBN 9789928817143

© 2020 Mondadori Libri S.p.A., Milano

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

*Kushtuar luftëtarëve,
të çmendurve.*

“Shën Mëri, kam humbur shpirtin!
Më ndihmo, Shën Mëria ime!”

Errësirë dhe vetëm errësirë. Kjo duhet të jetë vdekja.

“Shën Mëri, kam humbur shpirtin!
Më ndihmo, Shën Mëria ime!”

Erë e djegur, bëhet gjithnjë e më e fortë, nxehtësi që bëhet zjarr, djeg.

Hap sytë mbi botë si të ishte hera e parë, me mundim i mbaj hapur, vetëm për pak.

“Shën Mëri, kam humbur shpirtin!
Më ndihmo, Shën Mëria ime!”

Pranë vetes shoh një të panjohur, duket si Shën Françesku, por i çmeritur nga halucinacionet, i palarë, tmerrësisht i dobët, me një çakmak në dorë. Era e djegur vjen nga flokët e mi, po më vë flakën, nga koka. Dua të kërkoj ndihmë, por nuk mundem, më duket sikur truri nuk arrin të komunikojë me pjesën tjetër të trupit.

Britma e një vajze në gjendje të trazuar shpërthen në ajër, kthej kokën, vjen nga goja e një dyzetvjeçareje, me flokët e kuq të lyer, të rrallë, të kthyer në njërën anë, bërtet sërish:

- Pino! Pino! Shën Mëria po i vë flakën këtij të riut!

Infermieri ngjan si një bark me dy këmbë, krejt i bardhë, afrohet te dera dhe nxiton sapo sheh se çfarë po ndodh.

- Ça kopili paske qenë! Ku mutin e gjete çakmakun?

“Shën Mëri, kam humbur shpirtin!

Më ndihmo, Shën Mëria ime!”

Infermieri kalon përpara meje, me një lëvizje të beftë ia rrëmben çakmakun nga dora të çmendurit, ai nuk thotë gjë, e lë ta shtrijë në shtrat pa çfarëdolloj reagimi, një kafshë befas e parrezikshme, e pambrojtur.

- Ça të t’bëj unë ty, o Shën Mëri? Po më krijove ndonjë problem tjetër sot, të mbylla prapë në banjë.

Trupi im do të bjerë përsëri në gjumë, por unë nuk pranoj, mundohem me çdo mënyrë të rezistoj, mundohem të flas, më kot.

Infermieri kthehet nga unë, kalon njërën dorë në anën e kokës që po merrte flakë, një erë si e një pule të djegur ka mbetur në ajër, ai buzëqesh i vetëkënaqur:

- S’të bëri gjë, flokët të rriten prapë për dy javë.

Kaq thotë dhe largohet.

Me atë pak kthjelltësi që më ka mbetur, përpiqem

të kujtoj, të marr vesh ku jam. Një dhomë spitali, me gjashtë shtretër. I nxehti që përzihet me erën e keqe, erë dezinfektuesi dhe djerse.

Burri që bërtiste si vajzë shikon përreth, hap pas hapi më afrohet, pamundësia për t'ia mbathur, për të bërë sado pak rezistencë, qoftë edhe vetëm duke bërtitur, ma shumëfishon tmerrin. Ai buzëqesh, e afron fytyrën te veshi im:

- Jam i virgjër.

E thotë si të ishte një ftesë e perefuzueshme.

Kam frikë, dua familjen time afër, shtëpinë, dhomën time. E di pse jam këtu, e di çfarë ka ndodhur. Turpi, ndjenja e fajit, kujtimi i mbrëmjes së djeshme më pushton, kërkon të kthehet në një të qarë. Por nuk mundem.

Kështu bie sërish në gjumë, duke lakmuar lot që nuk dalin.

DITA 1

E martë

Një dorë në sup, më shkund gjithmonë e më fort.

- Menkareli, hajde, çohu!

Është infermieri, po përpiket të më zgjojë.

- Hajde, se kaloi ora njëmbëdhjetë, për çerek ore vjen doktori.

Më kap nga shpatullat dhe më tërheq për lart.

- Mirëmëngjesi, zogu! U kënaqe me gjumë? Normale, me gjithë ato ilaçe që të rrasën në damar... Ma thua dot si quhesh? Provoje një herë.

Gojën e kam të tharë. Koka më gjëmon.

- Daniele. Daniele Menkareli.

Infermieri përçapet në njëfarë buzëqeshjeje. Duhet të jetë rreth pesëdhjetë vjeç, ndoshta edhe pak më i vjetër, në fytyrë dallohen vrajat e thella të akneve të viteve të shkuara.

- Bravo, Daniele! Ndërsa mua më quajnë Pino, dhe Pinoja ka qejf t'i sqarojë gjërat që në fillim: po u solle mirë, sillem mirë edhe un', po bëre si budalla dhe çun i keq, un' bëhem më i keq se ti, mir'? Nuk po të rrej, ne që jemi në rregull bëhemi më të këqij se të çmendurit, more vesh?

Fytyra e Pinos u bë e ashpër, e detyroj veten të përgjigjem, pavarësisht mpirjes së përgjithshme:

- E mora vesh.

- Edhe një rregull tjetër me rëndësi: nuk lejohet të bësh xhiro, mund të rrish këtu ose në dhomën e televizorit ngjitur. Kurrën e kurrës mos u fut te dhomat pas sallës së televizorit. S'janë si ju ata andej, janë të këqij, në rregull?

- Në rregull.

- Të lumtë, Daniele, po zgjohu tamam tani, se do të thërras doktorin! Këtu ke çaj, pi pak.

Më jep një filxhan të ngrohtë dhe largohet.

Kur të kthehet aftësia për të lëvizur trupin tënd, fillon dhe ndien, një nga një, një sërë dhimbjesh të shpërndara kudo: pas shpinës, në qafë, ama më shumë më dhemb dora e majtë. Është e mbuluar me një leukoplast të gjerë, në nyjat e gishtave ka pak gjak të tharë. Nga dora kaloj te mendimet që më vinë furishëm: muret, mobiliet, ekrani i televizorit derisa u bë copash. Ja ku janë shenjat. Pastaj, i pafund si qielli, shoh përsëri babanë tim, shtrirë në tokë si një i vdekur, falë shfaqjes që dhashë vetë.

Një mori sysh - janë të shokëve të dhomës. Gjashtë shtretër, të vendosur në dy rreshta. Tre shtretërit që kam përballë janë të zënë. Djali përballë meje duhet të jetë në moshën time, kur më fliste Pinoja, e vështroja herë pas here, tani jam i sigurt: qëkur fillova ta shikoja, nuk i ka hequr asnjë çast sytë nga një pikë e pacaktuar mbi kokën time. Duket sikur shikon përtej, në një të përtejme që e ka mahnitur tërësisht, dhe gjithçka që

ekziston pranë tij nuk është në gjendje ta kthejë në vete.

Në të majtën e tij, pranë dritares së madhe të dhomës, ndodhet një burrë rreth të gjashtëdhjetave, dhe sapo e pashë vura re një ngjashmëri të jashtëzakonshme: është identik me kitaristin e grupit “Queen”, por emrin nuk arrij t’ia kujtoj, ndërsa shtratin në të djathtë e ka zënë burri me zë vajze dhe që tani qëndron përpara një pasqyre dore, vendos shkëlqyesin e buzëve dhe ngërdheshet, buzëqesh, duket sikur po imagjinion një dialog, një vardisje.

Unë jam në qendër të rreshtit tjetër të shtretërve, në të majtë kam të çmendurin që donte të më vinte flakën, duket sikur është qetësuar, madje duket në gjumë.

Shtrati në anën e djathtë është i rregulluar dhe i pastër, duhet të jetë bosh.

Herë pas here, nga dhoma të tjera, botë të tjera, mbërrijnë disa klithma, rënkime nga ato që zbutin edhe gurin.

Pinoja hyn në dhomë.

- Menkareli, hajde! Po të pret Mançini.

Ngrihem me vështirësi, qëndrimi në ekuilibër më duket më i vështirë se zakonisht, Pinoja më kap nga krahu, kështu dalim dhe futemi në dhomën përballë tonës.

Studioja e mjekut është e vogël, Pinoja më ndihmon të ulem, pastaj del.

Përpara vetes kam mjekun, një gjë më bie menjëherë në sy: është jashtëzakonisht trupmadh. E dalloj nga krahët, nga dora me të cilën po shkruan rreshta të tërë mbi faqen e bardhë, me stilolapsin e ngjeshur fort. Po ta shohësh me vëmendje, edhe kokën e ka të madhe, ashtu si supet, nuk di të them për gjatësinë, por duhet të jetë gjigant.

- Atëherë, Menkareli...

Më flet pa e hequr shikimin nga letra, më në fund, ngrihet, ka sy shumë të vegjël ngjyrë blu, hundë të gjerë, flokët një pjesë gështenjë dhe pjesën tjetër të thinjur. Edhe pse fytyra ka diçka imponuese, gati të dhunshme, po të kisha sado pak shoqëri me të, do ta pyesja nëse luan apo ka luajtur ndonjëherë ragbi, sepse duket si ragbist i regjur.

- E mban mend sa është data sot? Dita, muaji dhe viti.

Pohoj me kokë dhe filloj të bëj llogaritë.

- Sot është e martë, 15 qershor 1994.

- 14, e martë, datë 14. E mban mend ditën, muajin dhe vitin e lindjes?

- 26 prill 1974.

- Pra, je njëzet vjeç. A e di pse të sollën këtu?

Përpara syve, të mprehta, të helmatisura, vërshojnë imazhe nga nata e kaluar.

- Po, për gjërat që ndodhën mbrëmë.

Doktori m'i ngul sytë pa e dhënë veten, vështrimi i bashkuar me shtatin jep rezultatin e një burri që nuk

është në gjendje të ndiejë emocione, të paktën kjo është përshtypja që lë.

- Nuk ke gjë tjetër për të thënë? Do të ma shpjegosh pse ndodhi?

- Tani për tani, jo.

Refuzimi im nuk i shkakton as edhe një hije reagimi.

- Si të duash, pasdite do të vijë doktor Çimaroli, ai u mor me rastin tënd mbrëmë në urgjencë. Më tregoi për shfaqjen që dhe mbrëmë. Urime! Për pak sa nuk e vrave babanë. Duhet talent edhe për atë punë.

Qëndroj në heshtje, ndërkohë që ai vazhdon të më studiojë dhe herë pas here shënon diçka në ato fletët e tij të çmuara, gjëra që me shumë gjasa kanë të bëjnë me mua.

- Gjithsesi. Që sot je në shtrim të detyrueshëm në spital (SHDS), e kupton se çfarë do të thotë?

Vendimin për kurën e ka marrë doktor Çimaroli, së bashku me kolegun e urgjencës. Kjo është procedura në këto raste, kemi njoftuar komunën ku je i regjistruar dhe gjykatën e Veletrit, sot në mëngjes na dërguan autorizimi e tyre me faks, kështu që për shtatë ditë do të jesh i shtruar në spital dhe do t'i nënshtrohesh mjekimit tonë.

Nuk kam më gjurmë të mpirjes kimike. Prandaj fillon ankthi, dëshpërimi.

- Çfarë do të thotë? S'shkoj dot në shpi?

Mjeku gjigant mohon duke tundur kokën.

- Nga sot, e martë 14 qershor, deri të hënën e ardhshme në datën 20, do të qëndrosh në repartin tonë. Mos e ke gjë problem?

Buzëqeshja që vuri në buzë nuk lë dyshime: dëshpërimi im e gëzon.

- Po sikur të sillem mirë? Sikur të sjell prindërit, të flisni edhe me ata? S'jam i keq, kam nja dy vjet që marr mjekim, kam folur me disa mjekë të tjerë. S'kam prekur njeri me dorë.

- E po, gjendja e babait, ajo që i bëre vetes... Gjithsesi, tani e tutje do ta vendosim ne nëse je i rrezikshëm apo jo, si dhe çfarë ke apo nuk ke. Si quhen mjekët që të kanë ndjekur?

- S'i mbaj mend të gjithë: Sanfilipi, Lorefiçe, Kastro, është edhe një tjetër, më duket.

- Paskan hequr të zitë e ullirit prindërit e tu që të kanë dërguar te gjithë këta mjekë, por do të kemi mundësi të flasim më shumë gjatë javës, kjo bisedë ishte vetëm për të të komunikuar vendimin. Unë jam doktor Mançini, pasdite do të takohemi edhe një herë bashkë me doktor Çimarolin, tani mund të shkosh në dhomën tënde. Ça mut vape bëka sot k'tu brenda!

Shfryrja e fundit, drejtuar vetes, i doli në dialekt, me siguri jugor, edhe pse nuk mund ta përcaktoj saktësisht se nga cili qytet.

Nga studioja e mjekut deri në dhomën time nuk janë më shumë se dhjetë hapa. I bëj ngadalë, fytyrat e babait dhe nënës, vëllait dhe motrës, më shoqërojnë në

heshtje. Qëkur kam lindur, kam sjellë vetëm rrëmujë, ekzagjerime njëra pas tjetrës, për mua gjithçka është një impuls për t'u ndjekur, për mirë a për keq. Nuk di të jetoj ndryshe, nuk di t'i shmangem kësaj egërsie: po të ketë një majë duhet ta arrij, nëse ka një humnerë duhet ta prek.

Teksa shtrihem në shtrat, shoh doktor Mançinin duke ecur nëpër korridor, në këmbë, me hapin e shpejtë, duket me të vërtetë si gjigant. Mundohem t'ia ndesh shikimin, por ai nuk do t'ia dijë, shpreh vetëm mëri, në mos përçmim. Fytyra e tij më mbetet në sy: si mund ta urresh kaq hapur një person që duhet ta kurosh? Gjatë këtyre dy vjetëve në udhën time të kryqit, mes psikiatërve dhe patologjive, jam mësuar me mënjanimin, me mungesën e dashurisë, ama deklaratë kaq të hapur urrejtjeje nga një mjek nuk kisha ndeshur ende.

- Ç'kemi?

Pa e kuptuar, pranë meje u shfaq burri me zë vajze.

- Garip Mançini, ëh? Ama, ka edhe më keq se ai k'tu brenda, dëgjo mua! Unë jam Xhanluka.

Dhe zgjat dorën me manikyr në drejtimin tim.

- Daniele, - dhe ia shtrëngo.

- Shtrim të detyruar edhe ty?

Pohoj me kokë.

- Edhe mua, që dje. Po ti çfarë ke bërë?

Xhanluka mund të jetë rreth dyzet vjeç, ka pak flokë, shumëngjyrësh, të hirtë, të djegur, të kuq të ndezur, i ka kthyer të gjithë në njëren anë, për

të mbuluar pjesët ku i kanë rënë, buzët e holla me shkëlqyes, të qeshura. Nuk i përgjigjem pyetjes që më bëri, por ai nuk do t'ia dijë.

- E mora vesh. Unë bëra një budallallëk, solla një shok në shpi, mami im si debile bëri namin, seriozisht, namin, dhe si përfundim ia futa nja dy, po unë jam e mirë, jam si rrush, në të gjitha kuptimet.

Dhe e shfaq edhe një herë atë buzëqeshjen që i duket provokuese, ndërsa mua më kujtohen fjalët që sapo i kisha thënë Mançinit: kushedi sa pacientë janë përpjekur ta bindin se janë të mirë.

- Tashi ta tregon Xhanluka jot kë kemi në dhomë. Atëherë, në krevatin ngjit' me dritaren kemi Marion, ka qenë mësues në fillore para se të çmendej, i mirë është edhe ai, si shpirt.

Kur dëgjon emrin, Mario kthehet nga ne, na buzëqesh, pastaj i kthehet vëzhgimit të pemës afër dritares, Xhanluka më afrohet edhe më shumë:

- Thotë që në pemë ka një zog të vogël, po s'e ka parë njeri tjetër deri sot, gjithsesi, ecim; në krevatin ngjitur me Marion kemi Alesandron, katatonik, sot pasdite vjen i ati dhe ta tregon ai gjithë historinë, atë muhabet ka ai me të gjithë, ndërsa në krevatin tjetër jam unë. Këtu është Shën Mëria, ai që po të vinte flakën, e thërrasim "Shën Mëri" se s'dihet gjë për të, nuk flet me njeri, përveçse herë pas here me Shën Mërinë. Këta janë të gjithë të shtruar në spital, vetëm ne të dy jemi me shtrim të detyruar të përkohshëm, i kemi ca gjëra të përbashkëta ne.

Me t'i thënë këto, më kërcet një puthje në faqe, pastaj qesh me të madhe, në mënyrë të tepruar.

- Sa e bukur është jeta! - më thotë një centimetër nga fytyra ime.

Unë hesht, sytë lëvizin nga një shtrat në tjetrin, nga një çmenduri në tjetrën. Ngadalë, të shpresuar, të pritur, rrjedhin lotët.

- Hajdeni, çuna, se erdhi dreka!

Te dera duket Pinoja, e thërras, ndërkohë që e qara është bërë e pandalshme.

- Dua të kthehem në shpi, ju lutem!

I shtrëngoj krahun, ai largohet ngadalë.

- Mos bëj kshu, një javë ikën shpejt, ke për ta parë sa mirë do të të bëjë.

Pastaj ngrihet: - Sot kemi supë të trashë dhe të hollë, patate të ziera dhe bizele, gjoks pule ose kotëletë, hajde.

Pinoja fillon të shërbejë drekën, duke parë pjatat më kalon përfundimisht edhe ajo pak uri që kisha, ndërsa Xhanluka dhe Shën Mëria hanë si të pangopur. Alesandroja, ai katatoniku, vazhdon ta ketë vështrimin atje tej, gjysmë metri mbi kokën time, nuk ka interes për asgjë në këtë dimension, as për ushqimin.

- E ha mollën e pjekur?

Mario më vjen afër, me flokët kaçurrelë, të thinjur, të ngritur lart si një shkurre e çrregullt mbi kokë.

Nga gjellët e ndryshme të drekës, vetëm molla e pjekur ma tërhoqi disi vëmendjen, ndonëse shumë pak, ndoshta më shumë për nostalgji: mamaja më ka

rritur me mollë të pjekura, ishin ilaçi i detyrueshëm i çdo gripi apo i çdo sëmundjeje tjetër.

- Jo, merre, pa merak.

Buzëqeshje të mira kam parë shumë, të mrekullueshme, por kjo i mundte të gjitha. E mirë, edhe pse e pambrojtur, me gjithë mirënjohjen që mund të ketë brenda një buzëqeshje.

- Mario ha vetëm mollë të pjekura, ia lëmë edhe tonat.

Xhanluka ndihet i detyruar të japë një shpjegim, si udhëheqës i vetëshpallur i departamentit.

- Faleminderit! - thotë Mario, duke më parë në sy me sytë e tij të njomë.

Kureshtja është e madhe, madje fiton edhe mbi dëshirën për t'u larguar, me një lëvizje të kokës thërras Pinon.

- Mos më merr për të çmendur, veç faktit që jemi në një vend të marrësh, po a e njeh grupin "Queen"? Grupin e Freddie Mercury-t?

Pinoja pohon me kokë.

- E di, Brian May, kitaristi, është identik, Marion e kemi thjesht pak më plak dhe më të çmendur.

- Nuk po më kujtohej emri, rrofsh!

Në orën dy pasdreke, veshur me rroba civile, shoh Pinon duke dalë me hap të shpejtë, nuk ma kthen përshëndetjen që i bëj me dorë. Në vend të tij shfaqet një infermier tjetër, më i ri, e sidomos më i dobët.

Vapa në dhomë është mbytëse, duket sikur vetëm unë dhe Xhanluka e vuajmë, ndërsa Shën Mëria dhe Alesandroja sikur nuk e vënë re aspak. Mario madje ka veshur një robdëshambër të rëndë mbi pizhame që janë gjithashtu të rënda dhe dimërore.

Nga pantallonat e hedhura brenda dollapit tim marr dyqind lireta, telefoni është në hyrje të repartit, pranë derës së kyçur.

- Daniele?

Gjithë jetën kam pasur bindjen se nëna kishte fuqi të mbinatyrshe, sidomos me ne fëmijët, një dhunti që e ndihmonte të kuptonte më shpejt dhe më mirë, përtej çdo fjale të mundshme, edhe gënjeshtër të ndërtuara mjeshtrërisht. E dinte që isha unë në anën tjetër të telefonit. Siguria absolute e dashurisë së saj, që mund të rrëzojë edhe ligjet e fizikës, ma heq edhe atë pak forcë që më ishte kthyer.

- Po, un' jam.

- Si je?

Diçka prej dhuntisë së saj na e ka përcjellë edhe neve, përmes gjakut ose ndoshta nuk nevojitet ndonjë dhunti e veçantë për të ndier shqetësimin e saj.

- Tani jam mirë, do të më mbajnë një javë këtu, e dije ti?

- Na e tha doktori mbrëmë, jemi dakord edhe ne, ti nuk mban mend, ama po bëje si i marrë. Si ndihesh tani?

Dora shkon në pjesën e kokës së djegur nga Shën Mëria, gishtat përkëdhelin lëkurën e kokës që ka

mbetur zbuluar; për fat të mirë, janë djegur vetëm flokët.

- Jam mirë, përveç faktit që këtu ka vetëm të çmendur, po të çmendur me *vërte*'.

Mamaja hesht, pastaj e vazhdon bisedën dhe ma bën të qartë arsyen e heshtjes së saj, zëri i dridhet, por e mban veten.

- S'kemi lënë doktor pa shkuar këta dy vjet, asnjëri s'ka qullotur gjë, mbase atje brenda do ta kuptojnë çfarë të mundon aq shumë, sepse një djalë njëzet vjeç duhet të jetë i lumtur, ndërsa ti vetëm trishtimin njeh, dhe ne s'dimë si të ta heqim.

Vetëpërmbytja që i kishte vendosur si qëllim vetes shkërmoqet si dheu i thatë.

- Unë dua të të shoh të lumtur, - kaq arrin të thotë, më pas dëgjohen vetëm ngashërimit.

- Po unë s'jam i palumtur, s'është halli te lumturia, më duket sikur jam i vetmi që e kuptoj që jemi të gjithë në fije të perit, që në çdo moment dikush nuk merr më frymë dhe e fusin në arkivol, sikur të mos kishte ndodhur gjë hiç, që koha mua më duket si fyerje, për ty, për babin, dhe më acarohen nervat. Ama në momente të tjera lumturia që kam brenda kap qiellin, ma beso, nuk e di njeri më mirë se unë se ç'do të thotë të jesh i lumtur.

Mamasë sime ndërkohë i është kthyer aftësia për të folur, madje edhe frymëmarrja duket më e rregullt.

- Pasdite do të vijë vëllai të të sjellë ca ndërresa, të kam marrë ca biskota dhe lëngje frutash, ke nevojë për gjë tjetër?

Do të doja t'i tregoja nënës për çfarë kam vërtet nevojë, gjithmonë të njëjtën gjë, që kur nxora klithmën time të parë në këtë botë. Ajo që dua nuk ka qenë e lehtë për t'u thënë për shumë kohë, mundohesha ta shpjegoja me koncepte të ndërlikuara, i kalova njëzet vitet e para të jetës sime duke kërkuar fjalët më të sakta për ta përshkruar. Dhe fjalë kam përdorur shumë, shumë, pastaj e kuptova që duhet të vazhdoja në drejtim të kundërt, kështu, ditë pas dite, fillova të heq nga një fjalë, atë më pak të nevojshmen, të tepërtën. Pak nga pak shkurtova, krasita, derisa arrita te një fjalë e vetme. Një fjalë për të thënë atë që dua me të vërtetë, që e kam me vetë që kur linda, madje përpara se të lindja, e që më ndjek si hije, gjithnjë e shtrirë krah meje: shpëtim. Këtë fjalë nuk ia them askujt përveç vetes. Por ja ku është fjala, e bashkë me të kuptimi i saj, më i madh se vdekja.

Shpëtim. Për vete. Për nënën në anën tjetër të telefonit. Për të gjithë fëmijët dhe të gjitha nënat. Dhe baballarët. Dhe gjithë vëllezërit e kohëve të shkuara dhe të ardhme. Sëmundja ime quhet shpëtim, por si? Kujt t'ia them?

Apo ndoshta kjo që unë e quaj shpëtim nuk është gjë tjetër veçse një nga emrat e shumtë të sëmundjes, ndoshta nuk ekziston dhe dëshira ime është thjesht një simptomë që duhet kuruar. Nuk më tmerron ideja e të qenët i sëmurë, me këtë po mësohem, por dyshimi se çdo gjë në këtë botë nuk është gjë tjetër veçse një rastësi e kozmosit, qenia njerëzore si një harbim jete, gabimisht.

- Jo, mami, s'kam nevojë për gjë tjetër, ti mos u bëj merak, mirë?

- Nuk do të bëhem merak kur të kthehesh në shtëpi.

“Shën Mëri, kam humbur shpirtin!

Më ndihmo, Shën Mëria ime!”

Shën Mëria u zgjua, është ulur në shtrat, duart i mban të hapura përpara syve, duket sikur po i studion, fillimisht kurrizin, pastaj pëllëmbët, duket i mahnitur nga aftësia për t'ua kontrolluar lëvizjet. Shkoj në shtratin tim dhe shtrihem, mund ta kem një metër larg. Nuk jam në gjendje ta përcaktoj çfarë moshe mund të ketë, ndoshta rreth të tridhjetave, fytyrën e ka të hequr, mjekrën e gjatë, sytë e largët e të përhumbur. Nga pizhamet e hapura, të vjetruara, dallohen qime të rralla në gjoks, më shumë bie në sy dobësia, i numërohen kockat. Por nuk më dhimbset për pamjen e vuajtur. Nuk është ajo arsyeja pse m'u mbushën sytë me dhembshuri. Pamja e tij është një pasojë e trishtë, është dylli i konsumuar i qiririt. Ndërsa mua më bën të qaj prushi i zi që i konsumon sytë. Një angështi kaq e thellë sa të merr frymën. Cila sëmundje mund të vendosë një barrë kaq të madhe mbi supet e një njeriu? Sepse barra që rëndon mbi trupin e gjorë të Shën Mërisë është kafshërore, çnjerëzore. E detyroj veten të mos e shoh dhe më vjen turp, sepse në kokë, vetëm për një çast, m'u ndez mendimi se bisha e angështisë që e ka bërë skllav mund të hidhet edhe mbi mua e të më marrë.

Sytë enden nëpër dhomë, veç Shën Mërisë kam edhe pacientin tjetër përballë meje, Alesandron, me shikimin gjithmonë të ngulitur mbi kokën time. Vendos të lëviz, të kërkoj ndonjë qenie njerëzore që të jetë në gjendje të flasë, nga dhoma ngjitur vjen zëri i prezantueses Marta Flavi. Në atë çast kthehet Mario nga banja, më buzëqesh teksa më kalon pranë dhe afrohet ngadalë te dritarja.

Në korridor kam mundësinë të shoh me kujdes pavijonin. Dhoma jonë, studioja e mjekut përballë, bashkë me disa dyer të tjera të mbyllura, dhoma e mjekimit dhe banjat për vizitorët: ky është grupi i parë që përfundon me sallën e televizorit, dhe më tej, një tjetër derë me xhama të errët, edhe kjo e kyçur, si dera në hyrje, që me siguri të çon në repartin tjetër, në anën e të ligjve. Kështu duhet të jetë.

Të përhumbur përpara televizorit gjëj Khanlukën dhe infermierin që mori turnin pas Pinos. Sapo më sheh, ngrihet dhe me vjen pranë.

- Ç'kemi?

I përgjigjem me një lëvizje të kokës. Infermieri mund të jetë e shumta tridhjetë vjeç, është i ngathët, i turpshëm.

- Unë quhem Lorenzo. T'i sqarojmë ca gjëra që në fillim. Ti s'më çan trapin mua, unë s'të çaj trapin ty. U morëm vesh?

Në mënyrë pa dyshim më të rrëmujshe dhe më i kufizuar në aftësinë për të ngjallur frikë, infermieri Lorenzo përsëriti paralajmërimin e Pinos. Falë tij e

kuptoj më së miri kuptimin e vërtetë të atyre fjalëve: ne sulmojmë të parët nga frika se do të na sulmojnë të tjerët. Sepse Lorenzoja ka frikë, e tregon çdo pjesë e trupit të tij. Nuk duhet të jetë gjë e lehtë të rrish çdo ditë me një tufë të çmendurish.

- Mos e vrit menjen, realisht, unë jam i qetë fare, quhem Daniele.

Por përpjekja ime për ta qetësuar duket sikur nuk jep ndonjë rezultat.

- Tani vjen Çimaroli, apostafat për ty, të thërras unë sapo të jetë gati.

Me të thënë këtë, Lorenzoja del nga dhoma.

Ndërkohë, në televizor, Marta Flavi interviston një burrë rreth të dyzetave, një tjetër zemërthyer në kërkim të një dashurie të re.

- Tashi, nga pamja ky qenka copë-copë, po mund të jetë djalë i mirë, se nuk janë të gjithë të bukur, si Daniele, për shembull.

Xhanluka më vuri re kur hyra në sallë dhe kaloi përsëri në sulm; rreh qerpikët, buzëqesh, pastaj një dëshirë e zjarrtë i shfaqet në sy.

- Xhanluka, po ta them tani dhe mos ta përsëris më. Mua më pëlqejnë gocat, more vesh? Po të duash, mund të bëhemi shokë, me gjithë qejf, por mos bëj nga këto skenat vazhdimisht, se më lodhe, u morëm vesh?

Si përgjigje afrohet, me fytyrën një pëllëmbë larg simes, në sy një dëshirë e ethshme:

- S'e ke idenë ça po humb. Sidomos nga goja.

Qëndroj pa lëvizur, nuk bëj asgjë për ta fshehur bezdinë që po më shkakton.

Xhanluka do ta vazhdojë lojën e joshjes, por nuk i ecën më si më parë.

- E mirë, problem i madh! U morëm vesh: shokë. Vetëm se kur jam në fazën e bardhë vetëm te seksi e kam mendjen, dua dhe unë të jem më e qetë, por kam një energji, një dëshirë që s'ka fund, një uri për gjithçka.

I peshoj fjalët e tij, përpiqem ta zbus instinktin tim, të mos i dorëzohem, por nuk mundem:

- Të të bëj një pyetje? M'fal po u bëra kureshtar, çfarë është faza e bardhë?

Xhanluka më afrohet sërish.

- Unë jam bipolar, po rëndë fare, ça t'i bësh, faza e bardhë është kur jam mirë, madje më mirë se ç'duhet, dhe, në fakt, doktorët ma kanë thënë që edhe gjithë kjo eufori simptomë është, mua më duket e mirë, por, në fakt, është sëmundje. Pastaj është faza e zezë, domethënë kur jam vërtet keq, ajo është e tmerrshme fare, herën e fundit shkova dyzet e shtatë kile. Kur jam në fazën e bardhë mendoj vetëm për seks. Kur jam në fazën e zezë dua vetëm të vdes.

Xhanluka mundohet të buzëqeshë, por nuk mundet.

- E di unë që një ditë te faza e zezë do të ngec.

Ai parashikim i shkëlqen në sy, duket sikur sheh fundin e tij. Për një çast i shfaqet në fytyrë vajza që ulërinte në mëngjes, duket e frikësuar, e dorëzuar, e fshehur nën flokët e rrallë të çngjyrosur, në mjekrën e thinjur në faqe.

E shikoj dhe më duket sikur çdo gjë brenda tij kërkon ndihmë.

- Ça thu? Ti je i fortë, e di ç'a do bëj tashi? Do ta marr në telefonon Marta Flavi-n, t'i them të ta prezantojë atë kastravec in që ka aty në emision.

Xhanluka i kupton që në ajër fjalët e mia dhe i kthehet në çast buzëqeshja e tij verbuese.

- Sa mirë do të ishte. Do na vije për darkë në shpi pastaj.

- Normale, do të sillja edhe ëmbëlsirën.

- Mos më fol më për ëmbëlsira, se, përveç seksit, as te të ëmblat nuk di të përmbahem.

Lorenzoja shikon nga dera e xhamit.

- Menkareli në studion e mjekëve!

Unë ngrihem, ndërsa Xhanluka kthehet te Marta Flavi.

- T'fala mjekëve!

Në studio gjej doktor Mançinin, pranë tij një burrë tjetër me një përparëse laborator, rreth të pesëdhjetave, mbi fytyrën topolake ka një palë syze të rumbullakëta, pikërisht ato ma ndezin kujtesën.

Sapo afrohem, më zgjat dorën: - Më mban mend?

Pohoj me kokë.

- Jam doktor Çimaroli, mbrëmë më thirrën në urgjencë për një konsultë, sepse ti ishe pak nervoz, le të themi.

- Ashtu është, për fat të keq.

- U mundova të të pyesja se çfarë të kishte zemëruar aq shumë, por nuk m'u përgjigje, dhe si përfundim na